



Datë: 12.06.2025

Numër Protokolli: 4037/2025

A.nr.173/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.173/2025, të datës 22.01.2025, të parashtruar nga ankuesja, F.H-M, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, në seancën për këshillim dhe votim të datës 12.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.173/2025, e datës 22.01.2025, e parashtruar nga ankuesja, F.H-M.
- II. Anulohet** në tërësi procedura e pranimi me numër reference RN00015621, Grupi i Shërbimit të Jashtëm, pozita Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- III. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm dhe Divizioni i Burimeve Njerëzore, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të ndërmarrin të gjithë veprimet e nevojshme administrative në kuptim të zbatimit të këtij vendimi sikurse përcaktohet në pikën **II** të dispozitivit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, F.H-M (*tutje referuar* Ankuesja), më datë 22.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit me numër protokolli 91, të datës 10.01.2025, të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, lidhur shpalljen e kandidateve fitues në procedurën e pranimi me numër reference RN00015621, pozita *Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm*.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 31.01.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 11.02.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 456/2025 e datës 22.01.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankueses; Konkursin me numër të referencës RN000115621 Grupin e veçantë ad hoc për Shërbimin e Jashtëm pozita Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm; Njoftimin për kandidatët fitues me numër protokolli 91 i datës 10.01.2025 i publikuar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Kërkesën për përgjigje në ankese e datës 31.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 11.02.2025; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë datë 08.01.2025 për ankuesen dhe kandidatët fitues; Formularët e vlerësimit të eses i datës 25.12.2024; Lista e aplikantëve; Njoftimin e datës 11.12.2024 për verifikim paraprak; Njoftimin për testin me shkrim I datës 18.12.2024; Vendimin me Nr. 0472 /2024 të datës 21.08.2024 të Ministrit të MPB për miratimin e grupit të veçantë ad hoc për shërbimin e jashtëm; Njoftimin për intervistë me gojë I datës 03.01.2025; Formularin e përshkrimit të punës për pozitën Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm; Vendimin Nr. Ref 624/2024 të datës 12.12.2024 për themelimin e Komisionit të vlerësimit dhe akt emërimet e anëtareve të këtij komisioni; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 10.01.2025; Akt Emërimi i datës 01.02.2025 I M.A; Testin me shkrim; Aplikacionin e ankueses të datës 24.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-24; Aplikacionin e kandidates SH.B-R të datës 21.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-33; Aplikacionin e kandidatit N.I të datës 30.10.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-14; Aplikacionin e kandidatit B.H të datës 25.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-51; Aplikacionin e kandidatit A.Th të datës 20.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-13; Aplikacionin e kandidates D.B të datës 27.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-13; Aplikacionin e kandidates G.N të datës 01.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-08; Aplikacionin e kandidatit A.S të datës 18.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-21; Aplikacionin e kandidatit A.P të datës 08 .11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-26; Aplikacionin e kandidatit S.A të datës 06.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-36; Aplikacionin e kandidatit Xh.B të datës 24.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-45; Aplikacionin e kandidatit A.Z të datës 22.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-32; Aplikacionin e kandidatit A.A të datës 24.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-23; Aplikacionin e kandidatit A.H të datës 07.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-14; Aplikacionin e kandidatit A.G të datës 31.10.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-22; Aplikacionin e kandidates V.M të datës 27.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-103; Aplikacionin e kandidates A.M të datës 23.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-29; Aplikacionin e kandidatit A.G të datës 18.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-32; Aplikacionin e kandidatit M.A të datës 26.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-27; Aplikacionin e kandidates A/B-M të datës 20.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-25; Aplikacionin e kandidatit E.F të datës 20.11.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-26; Aplikacionin e kandidatit R.M të datës 30.10.2024 me dokumentacionin nga faqe 1-78, emaili i datës 24.10.2024 nga H.B për E.D-DMZB, si dhe përgjigja e Q,D-DMZP përmes emailit të datës 25.10.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, ***sepse:***

Nga analizimi i provave të lëndës, rezulton se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 28.10.2024, ka shpallur konkursin me numër reference RN00015621, për grupin e veçantë ad hoc për Shërbimin e Jashtëm, pozitat e punës *Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm*, klasa profesional 2, njëzet e një (21) vende pune, me afat aplikimi nga 29.10.2024 deri më 27.11.2024.

Rrjedhimisht, në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej 157 kandidatë, ashtu që vetëm 60 kandidatë, përfshirë edhe ankuesen, janë evidentuar në fazën e verifikimit paraprak si kandidatë që kanë plotësuar kriteret për pozitën e shpallur. Gjegjësisht, ankuesja i është nënshtruar fazës së vlerësimit profesional (testit më shkrim dhe intervistës më gojë), duke arritur në total 68 pikë të përgjithshme, si pikë të pamjaftueshme për tu shpallur kandidate fituese.

Tutje, sipas Njoftimit me numër protokolli 91, të datës 10.01.2025, si akt përfundimtar në këtë procedurë, rezulton se si kandidatë të sukseshëm dhe njeherazi si kandidatë fitues janë shpallur: kandidatja V.M me 89.2 pikë, kandidati S.A me 87.6 pikë, kandidati Xh.B me 6.4 pikë, kandidati A.Z me 85.6 pikë, kandidati A.A me 83.4 pikë, kandidati A.P me 81.4 pikë, kandidatja G.N me 79.2 pikë, kandidati A.H me 77.6 pikë, kandidati N.I me 79.6 pikë, kandidati B.H me 76.2 pikë, kandidatja Sh.B-R me 75.6 pikë, kandidatja A.M me 74.8 pikë, kandidati E.F me 74.4 pikë, kandidati M.A me 74.2 pikë, kandidati A.G me 74.2 pikë, kandidatja A.B-M me 73.2 pikë, kandidatja D.B me 72.8 pikë, kandidati A.S me 72.6 pikë, kandidati A.Th me 72.4 pikë, kandidati R.M me 71.2 pikë si dhe kandidati A.G me gjithsejtë 70.8 pikë.

Ankuesja brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më pretendimin së procedura e kontestuar është përcjell me parregullsi ligjore. Shton së vlerësimi i CV nuk ka qenë objektiv, ngase, duke marr parasysh kualifikimin arsimor, përvojën e punës vlerësimi i jetëshkrimit duhet të jetë maksimal. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, ashtu që të kthej çështjen në rivlerësim të jetëshkrimit ose anulimin e konkursit përkatës.

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se *1.Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe sprovues të Kosovës; 1.2. anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm.... 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkëlqeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin. 3. Ne rast të rregullimit me ligj të veçantë, për shërbyesin civil me status të veçantë - dispozita mbizotëruese janë dispozitat e ligjit të veçantë...* Kolegji i Këshillit konstaton së nëpunësit e shërbimit të jashtëm kanë statusin e nëpunësve civil me status të veçantë, respektivisht marrëdhënia e punës dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës i nënshtrohet rregullimit ligjor sipas Ligjit bazik për Zyrtarët Publik dhe ligjeve të veçanta lidhur me fushat e specifikuara sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij ligji.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, si dhe duke u bazuar në autorizimet ligjore sipas nenit 86, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes*, ka analizuar në kuptim të ligjshmërisë veprimet administrative të ndërmarra lidhur me

procedurën e kontestuar më ankesë, e mbi këtë bazë, fillimisht Kolegji ka shqyrtuar aktin e shpalljes së konkursit publik me numër reference RN00015621, dhe si rrjedhojë ka konstatuar së procedura në fjalë e pranimi është shpallur si Grupi i veçantë ad hoc për Shërbimin e Jashtëm, më Klasë Profesional 2, ndërsa, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar : **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë universitare (së paku tre vite të studimeve me 180 ECTS) në fushat si vijon: Shkenca Politike, Juridik, Marrëdhënie ndërkombëtare, politika të sigurisë, studime evropiane, Ekonomi, Juridik, Diplomaci (ekonomike, publike dhe kulturore) Administratë Publike, Fakulteti Filologjisë dhe Fakulteti i Filozofisë. Përvoja e punës e kërkuar:* Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës. **Kriteret specifike shtesë:** Njohja e gjuhës angleze, gjermane. Frënge, italiane. Greke, spanjolle, apo serbo kroate në nivelin C1 apo C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime universitare të kryera në këtë gjuhë.

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore të çështjes iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, që rregullojnë procedurat e pranimi në shërbim civil, më theks të veçantë:

-Nenit 9 paragrafi 1: [Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik]. 1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kalojë me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në këtë ligj. 2. Përgjatimisht, për pozita specifike të zyrtares/it publik, mund të kërkojnë kriteret specifike shtesë. Procedura dhe kriteret për plotësimin e përshtatshmërisë dhe/apo të kriterëve specifike shtesë, do të përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike.

-Nenit 39 [Procedura e pranimi në Shërbimin Civil]: 1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përgjatimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimi i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të

kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës”.

Po ashtu, në trajtimit të drejtë të kësaj çështje Kolegje iu referua edhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, gjegjësisht:

- **Neni 19:** 1. Kriteret specifike, për pozita të caktuara, mundet të përcaktohen vetëm gjatë procesit të miratimit të përshkrimit të vendit të punës. 2. Kriteret specifike mund të përcaktojnë kualifikimin, licencimin dhe/apo certifikimin e posaçëm që kërkohet për pozitën përkatëse.

-**Neni 20:** 1.Kriteret specifike, për pozita të caktuara, mundet të përcaktohen vetëm gjatë procesit të miratimit të përshkrimit të vendit të punës. 20.2. Kriteret specifike mund të përcaktojnë kualifikimin, - licencimin dhe/apo certifikimin e posaçëm që kërkohet për pozitën përkatëse....

-**Neni 28:**1. Për qëllim të organizimit të procedurave të rekrutimit në shërbimin civil të Kosovës, pozitave e kategorisë së specialistëve dhe profesionale grupohen sipas natyrës së pozitës në: 1.1. grupet e pozitave të administrimit të posaçëm; 1.2. grupin e pozitave të administrimit të përgjithshëm. 2 4.1. grupeve të veçanta të përcaktuara në bazë të fushës të arsimit të kërkuar; 4.2. klasës së pozitave. 5. Grupet e veçanta sipas fushës së arsimit përcaktohen në Shtojcën Nr. 2, dhe janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje. Fushat e arsimit në Shtojcën 2, përfshijnë të gjitha drejtimet përaktëse të asaj fushe.

-**Neni 30:** 1. Përjashtimisht, nëse një apo disa pozita të caktuara nuk mund të grupohen në një nga grupet për shkak të kërkesave të ndryshme për pranim, institucioni që ka vendin punës mund t'i kërkojë Ministrin përgjegjës për Administratën Publike, autorizimin e krijimit të një grupi të veçantë ad hoc. 2. Ministri miraton apo refuzon kërkesën në bazë të rekomandimit të dhënë nga DMZP. 3. Miratimi sipas paragrafit 2 të këtij neni është i përkohshëm dhe mund të shërbejë vetëm për zhvillimin e një procedure rekrutimi për atë grup.

Neni 31: 1. Me qëllim të lehtësimit të procesit të klasifikimit dhe grupimit të vendeve të punës për kategorinë profesionale, hartohet katalogu i vendeve të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe miratohet nga Qeveria, me propozim të Ministrisë Përgjegjëse për Administratë Publike. 2. Katalogu i vendeve të punës përmban emërtimin e pozitës, kategorinë, klasën, grupin dhe kriteret e përgjithshme si dhe përshkrimin e vendit të punës për çdo pozitë. 3. Përjashtimisht paragrafit 2 të këtij neni, hartimi për herë të parë i përshkrimit bëhet sipas nenit 21 të kësaj rregulloreje. 4. **Për pozita specifike të kategorisë profesionale në katalogun e vendeve të punës apo në legjislacionin përkatës mund të përcaktohen kritere më të larta sesa kriteret e përgjithshme të përcaktuara në shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.** 5. Katalogu i vendeve të punës miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, brenda një (1) muaji nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje. 6. Kur paraqitet nevoja për shtimin e pozitave të reja në katalogut të vendeve të punës, miratimi i pozitës së re bëhet nga Ministri përgjegjës për Administratë Publike me propozim të DMZP-së.

-**Neni 32** Dispozita kalimtare për grupimin 1, Deri në miratimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, që përcakton grupin të cilit i përket një pozitë pune, grupi të cilës i përket një pozitë, përcaktohet rast pas rasti nga Njësia Përgjegjëse.

Andaj, bazuar në kuadrin ligjor si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se lidhur me pozitën “Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm, klasa profesional 2, kriteret e përgjithshme formale referuar fushës së arsimit janë përcaktuar dhe vendosur në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ndërlidhur me Shtojcën Nr. 2: (Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm) si dhe në kundërshtim të plotë më Katalogun e Vendeve të Punës për

Shërbimin Civil,(i miratuar më datë 23.10.2024 sipas Vendimit Nr.08/226 të Qeverisë së Republikës së Kosovës), për faktin se pozita zyrtar i shërbimit të jashtëm sipas natyrës së pozitës grupohet të grupi i veçantë “Shërbimit të Jashtëm”, ku si fusha të arsimit janë përcaktuara: *Shkenca Politike, Juridik, Marrëdhënie ndërkombëtare, Politika të sigurisë, studime evropiane, Ekonomi, Juridik dhe Diplomaci (ekonomike, publike dhe kulturore) Administratë publike*, ndërsa, organi i punësimit me rastin e shpalljes së konkursit të kontestuar përveç fushave të përcaktuar më aktet si me sipër, ka vendosur edhe fusha shtesë të arsimit si *Fakultetin e Filologjisë dhe Fakultetin Filozofik*.

Nisur nga fakti së procedura e pranimi më numër reference RN00015621, ishte shpall si grup i veçantë ad hoc, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave të administruara ka gjetur së organi i punësimit në këtë rast MPJD-ja shpalljen e këtij konkursi, e kishte bërë mbi bazën e Vendimit nr.1472/2024, të datës 21.08.2024, të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, vendimi ky që ishte nxjerrë dhe rrjedhimisht ishte aplikuar për procedurën e pranimi me numër reference RN00014985, të shpallur nga MPJD më datë 03.09.2024, ku dhe në pikën dy të dispozitivit të këtij vendimi thuhet se: **“Grupi i veçantë ad hoc për shërbim të jashtëm sipas pikës 1 të këtij vendimi, është i përkohshëm dhe mund të shërbej vetëm në një procedurë rekrutimi për atë grup”** pra, ky vendim ka qenë i vlefshëm-aplikueshëm vetëm për procedurën e pranimi më numër të referencës RN00014985, dhe së ky akt nuk derivon pasoja juridike për procedura tjera të rekrutimit, e mbi këta fakt nuk ka mundur të aplikohet edhe për procedurën e kontestuar, edhe pse Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik sipas kërkesës së MPJD-së të datës 24.10.2024, kishte rekomanduar përsëritje të konkursit sipas këtij vendimi.

Në kontekst të çështjes së grupeve të përkohshme-ad hoc siç parashihet me nenin 30 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Kolegji thekson faktin së qëllimi i kësaj norme juridike është përcaktimi i përkohshëm i grupit dhe jo përcaktimi i kriterëve shtesë formale për pozitën e caktuar dhe se aplikimi kësaj norme ligjore vie në shprehje vetëm në rastet ku grupimi nuk është i mundur sipas rregullores për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil dhe katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil.

Rrjedhimisht, vendosja e kriterëve formale në kundërshtim më dispozitat materiale përben shkelje esenciale ligjore, kështu që, duke qenë se akti i shpalljes së konkursit me numër reference RN00015621 është i përfshirë me shkelje të tilla ligjore, atëherë, në kuptim të nenit 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, çdo veprim tjetër procedural i ndërmarrë në këtë procedurë është juridikisht i pavlefshëm dhe nuk prodhon efekte juridike, kështu që, mbi këtë bazë të konstatimit, Kolegji nuk ka trajtuar pretendimet ankimore referuar fazave tjera procedurale, të pasuara pas përmbylljes së konkursit përkatës.

Thënë si më lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, duke anuluar në tërësi procedurën e pranimi të shpallura sipas konkursit me numër reference RN00015621.

Në vështrim të detyrimit ligjor lidhur me parimin e informimit dhe ndihmës aktive (*neni 11 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative*) Kolegji sjell në vëmendje faktin se njësia përgjegjëse, në këtë rast Njësia e Burimeve Njerëzore në MPJD më rastin e ri shpalljes së konkursit për pozitën Zyrtar i Shërbimit të Jashtëm, duhet të siguroj që kriteret e përgjithshme formale të jenë në përputhshmëri më Rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e pozitave të nëpunësve civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbim Civil.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.173/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses F.H-M;
- MPJD: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Divizionit të Personelit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.